




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr.01-060/01-15633/22 datë: 20.06.2022



Npi – 01/185 datë: 28.06.2022

Dukë u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 28.06.2022 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -III- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 28.06.2022 (e martë) në ora 9:00 h. në sallën e Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushi, znj.Adelina Beqaj znj.Saniye Sadiki, z.Kadri Emininj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ-së, z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar, z.Shpëtim Gashi, zyrtar për informim, znj.Valmira Hoxha, praktikante.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përvendoset gjithë tē pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

R E N D D I T E

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025 (Pas diskutimit publik),
2. Propozim -Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionin për ndarjen e Bursave për Student,
3. Propozim – vendim për miratimin e Komisionit për përzgjedhjen e drejtoreve të shkollave,
4. Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit për Çerdhe në fshatin Petrovë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht aprovoi rendin e ditës.**

Pika 1

Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025 (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Përvendosje, Ky është një dokument i rëndësishëm për Komunën tonë. Bazuar në vendimin e Kuvendit për ta nxjerrë në diskutim publik, ne i kemi organizuar disa debate publike me qytetarë dhe me grupet e interesit. Dhe në fund kemi ardhur te një dokument final, të cilin ju e keni marrë me kohë, gjithashtu i keni marrë edhe procesverbalet e debateve publike. Propozimet që janë dhënë shumicën e tyre i kemi integruar në draftin e KAB-it. Në vazhdim spjegoi datat dhe vendet se ku janë mbajtur debatet publike. Ne e kemi kryer obligimin tonë për sa i përket debatit publik edhe pse pjesëmarrja nuk ka qenë në nivelin e dëshiruar. Nëse ka ndonjë pyetje jam gati të përgjigjem, përndryshe ju ftoj që ta miratoni.

z.Pérparim Ramusa; Faleminderit pér prezantimin, dhe pér punën në teren. Ndryshimet nuk kemi mujt me i lexuar sepse Kanë ardhur dje. Pyetje, 46 mijë euro pér rrugën Pjetërshticë-Zborc sa e di unë kjo ka qenë e planifikuar

z.Grejtalb Emini, dr ejtor i DPUKGJ; Rruga Zborc-Pjetërshticë është projekt dy vjeqarë dhe është në proces e sipër, 46 mijë euro kanë me u paguar sivjet.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Materiali është punuar nëpër drejtori, dhe ky është draft, dhe mundet me u ndryshuar. Pastaj e kemi edhe Qarkoren e dytë ku aty mund ti përmirësojmë gabimet nëse ka.

z.Pérparim Ramusa; Unë pér momentin nuk kam rekomandim, sepse materiali na ka ardhur dje, kështu që unë propozoj që ta dërgojmë në Kuvend pa rekomandim.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Po ndërlidhem në diskutim sepse kemi qenë në disa debate publike. Kjështu që ky draft nuk është 100% por ndoshta 80-90%. Më vonë do ta kemi edhe KAB-in dy, mirëpo sa i përket fshatrave janë përfshirë tëp gjitha. Gabimet që u përmenden duhet të përmirësohen. Shuma mund të ndryshojë nëse duhet me bërë përmirësim. Për këtë arsy ne duhet me qu KAB-in me rekomandim, nga KPF-ja dmth. me rekomandim që të përmirësohet projekti në shumën prej 46 mijë eurove, ndërsa nëse duhet të hiqet atëherë të propozohet se ku duhet të shkojnë këto mjete.

z.Pérparim Ramusa; Ideja jote pér rekomandim është e gabuar. Kuvendi mundet me pranuar ose jo. Unë mendoj se nuk duhet me pas rekomandim.

z.Kadri Emini; A janë futë propozimet e qytetarëve në KAB, sikurse edhe kërkesat që janë bërë më herët. Sepse sa e di unë ka kërkesa me shkrim nga fshati Rashincë.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Të gjitha kërkesat që kanë ardhur te ne i kemi marrë parasysh. Ideja është që të merren parasysh para së gjithash kërkesat kolektive se sa ato individuale, në këtë kuptim kemi qenë të kujdeshshëm. Ne kmi me pas kërkesa edhe pas miratimit të KAB-it.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Paska ndodhë një gabim teknik te emri i projektit rruga “Pjetërshticë – Zborc” ndërkaq që është dashur me qenë projekti i rrugës “Godanc i epërm – Zborc”. Kodi i rrugës 51500 Godanc i epërm – Zborc është gabim. Numri i projektit te drfatit i KAB-it është gabim që duhet të përmirësohet.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Komiteti pér Politikë dhe Financa, me 3 vota “Pér” me 1 votë “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” vendosi që t’i rekomandoi Kuvendit miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023-2025, me vërejtjen që KAB-i të rishikohet edhe një herë nga ZKF-ja, me qëllim të përmirësimit të gabimeve teknike, para se me ardhë në Kuvend.

Pika 2

Propozim -Vendim pér zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionin pér ndarjen e Bursave pér Student
Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin pér këtë pikë.

z.Pérparim Ramusa; Më gëzon fakti që numri i bursave është rritë. Unë propozoj që në Kuvend ta miratojmë vendimin pér formimin e Komisionit me qelësin një anëtarë nga pozita dhe një nga opozita.

z.Kadri Emini; E përkrahu propozimin 1+1 pozitë-opozitë, por me vërejtjen që në Kuvend të vijnë edhe emrat e anëtarëve tjerë nga Ekzekutivi dhe shoqeria civile.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Komiteti pér Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t’i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Vendimit pér zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionin pér ndarjen e Bursave pér Studentë, sipas qelësit 1 përsaqësues nga pozita dhe 1 nga opozita, si dhe me kërkesën që në përbërjen e Komisionit të na vinë edhe emrat e kandidatëve të Komisionit nga Ekzekutivi.

Pika 3

Propozim – vendim për miratimin e Komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Nuk e dimë formulën ose përbërjen e Komisionit, për këtë arsyе unë propozoj që të shkojë në Kuvend pa rekomandim.

z.Lulzim Muharremi, zyrtarë ligjor; Përshëndetje, unë mendoj se rekomandimi duhet të bëhet ashtu që të thuhet se kjo pikë të dikutohet në Kuvend me spjegimet e drejtorit t Kuvend me spjegimet e drejtorit të DKA-së.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, që kjo pikë të diskutohet në Kuvend me spjegimet që do ti jep drejtori i Arsimit.

Pika 4

Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit për Çerdhe në fshatin Petrovë

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emnini, drejtor i DPUKGJ; Përshëndetje, kjo çështje është stërgjatë, u bë temë politike, e që sështë dashur. Tërsia totale e asajë parcele ku ne kemi propozuar është 1 hektar e 93 ari, prej tyre 1 hektarë e 13 ari janë varreza, ndërsa pjesa tjeter prej 80 ari është e lirë. Kemi pas diskutim me përfaqësuesit e fshatit Petrovë, dhe të gjithë kanë qenë 100% "Pro". Ne aty kemi planifikuar që të ndajmë 7 ari truall për Çerdhen e fëmijëve. E kemi një procesverbal që kemi diskutuar në fshatin Petrovë, prandaj unë mendoj se janë pjekur kushtet dhe ju ftoj që ta votoni.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, unë po e shoh që ka qenë një pëlqim nga këta 12 përfaqësues, por paska një ndryshim dhe unë nuk e di se sa na lejon Udhëzimi Administrativ në këtë hapsirë sepse aty nevoitet edhe këndi i lojrave për fëmijët. Nëse nuk ka aty varreza jemi okej, pasi që nuk po kemi lokacion tjetër. Unë nuk jamë definitive.

z.Grejtalb Emnini, drejtor i DPUKGJ; Duke marrë parasysh që qeverisja jonë ka premtuar ndërtimin e 50 Çerdheve. Unë kamë kërkuar nga përfaqësuesit e fshatit që të diskutojmë sa të doni, dhe kemi diskutuar por nuk ka dale asnjë propozim tjetër, për ndonjë lokacion tjetër. Nëse na mbetet që gjatë ndërtimit të Çerdhes të bëhet në një formë një lloj izolimi me gardh të gjelbërt ose diqka tjetër nga ana e varrezave. Për sa i përket Udhëzimit Administrativ, duhet me kërkuar sqarim nga DKA-ja.

znj.Adelina Beqaj; Për këtë arsyë unë thash se duhet me u specifikuar dhe me u marrë pëlqim nga DKA-ja.

z.Përparim Ramusa; Me një gjë nuk u pajtova me drejtorin, që tha u bë diskutim politik, unë mendoj se nuk është keq sepse siç po shihet nga 15 ari ka ardhure në 7 ari. Një qytetarë ka thënë se varrin e babgjyshit e ka aty, prandaj vota ime ka me shkuar për "Abstenim".

z.Kadri Emini; Kryetari ka thënë se rrezikohet krejt me e humbë projektin nëse nuk e caktojmë lokacionin, për Çerdhe në fshatin Petrovë. Ta shohim nëse është e saktë deklarata e Muhamet Ademaj, se ka thënë se varri i babgjyshit tim është aty.

z.Lumni Amrushi; Është dashur më e thirrë më herët dhe me ba pyetje, e jo tash me na bë projekt. Mendone si përgjegjësi, e pastaj anën politike. Shumë qytetarë kanë thënë se aty ka varreza. Nëse nuk ka varreza, atëherë mua më mbetet merak që nuk e kam votuar "Për". Mirëpo pikërisht për shkak të shumë diskutimeve dhe hamendësimeve unë nuk mund ta votoj "Për".

z.Grejtalb Emnini, drejtor i DPUKGJ; Po flasim për dy njerëz, Muhamet Ademaj dhe Gani Ademaj. Gani Ademaj tash në diskutim publik, ka thënë publikisht se unë jamë "Pro" sepse varri i babgjyshit tim nuk është aty, por më tutje rrëth 100 metra. Qeveria po na e kërkon lokacionin sepse duhet me filluar me projektin. Ne do ta diskutojmë edhe më gjatë edhe në Kuvend.

znej.Adelina Beqaj; Ato varreza janë të lagjës Ademaj, në Kuvend kemi dy përfaqësues të lagjës Ademaj, nëse ju deklaroheni "Pro" atëherë unë nuk kamë problem.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë i kam konsultuar njerëzit më të vjetër të lagjës, edhe babën tim e kam konsultuar. Babgjyshi ka jetuar 99 vjet dhe është i varrosur naltë te varrezat e lagjës tonë. Realisht Çerdhja duhet me u ndërtuar. Edhe sikur të ketë varreza ato edhe mund të çvendosen komplet. Pastaj nëse i kemi kaluar mbi 100 vjet edhe moralisht edhe ligjërisht për mua është më mirë për me u ndërtuar Çerdhja, sepse aty ka me mbetë vend i mbeturinave. Prandaj deshëm e sdeshëm ne duhet me e bërë, sepse nuk kemi lokacion tjetër. Si përfundim unë jam i pajtimit, sepse në ata 7 ari të gjithë kanë thënë se nuk ka varreza.

z.Përparim Ramusa; Ideja jote për me i çvendosë varrezat, ose për me hjekë bërllogun është detyrë e DSHP-së. Me këto diskutime dhe me diskutimet shtesë të shkojë në Kuvend.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Në diskutimin publik që ka qenë i organizuar për këtë çështje të gjithë banorët pjesëmarrës kanë nënshkruar "Pro" për ndërtimin e Çerdhes. Unë do të votoj sinqerisht e jo politikisht, 100% "Pro" ndërtimit të Çerdhes në fshatin Petrovë. A ke ndonjë propozim ti Përparim se thaе që do të "Abstenojmë"?

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 3 vota "Abstenim" vendosi që t'i rekomandoi Kuvendit miratimin e Vendim për caktimin e lokacionit për Çerdhe në fshatin Petrovë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 11:01h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi